



KOMUNA E GRAÇANICËS

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për fushën e bujqësisë

Udhëzimet për aplikantët

Data e hapjes së thirrjes është: 04.12.2024

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është: 24.12.2024

Përmbajtja

1. Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për fushën e bujqësisë.....	3
1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE .	
3	
1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE.....	3
1.3 VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES.....	3
2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES.....	3
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: Kush mund të aplikojë?.....	3
2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit.....	3
2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes.....	4
2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes.....	4
2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme.....	4
2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme.....	5
2.4.3 Shpenzimet e papranueshme.....	5
3. SI TË APLIKONI?.....	5
3.1 Aplikacioni propozimi i projektit.....	5
3.2 Përmbajtja e formës së buxhetit.....	6
3.3 Ku ta dorëzoni aplikacionin?.....	6
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve.....	6
1.5 Si ta kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?.....	7
11. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE.....	7
1.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....	7
4.2 Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi.....	8
11. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES.....	8
12. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE.....	9

1. Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për fushën e bujqësisë.

1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Përmirësimi i bujqësisë në Komunën e Graçanicës

1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje janë:

- *Zhvillimi i bujqësisë dhe shtimi i aktiviteteve bujqësore,*
- *Hartimi i dokumenteve strategjike për zhvillimin e bujqësisë,*
- *Vizita e shembujve të suksesshëm dhe shkëmbimi i përvojave,*
- *Formimi i grupeve të punës dhe organeve për përpunimin statistikor,*
- *Mbështetje materiale direkte për fermerët,*
- *Rrjetëzimi me kooperativat tjera në Kosovë,*
- *Hartimi i projekteve për zhvillimin e bujqësisë,*
- *Komunikimi dhe koordinimi me institucionet dhe organizatat relevante.*

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të jetë:

Projektet që përfshijnë një numër të madh aktivitetesh të parapara me Thirrjen publike.

1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES

1. Për mbështetjen financiare publike për projektet/ programet në bazë të kësaj thirrjeje publike është paraparë shuma prej 65.000,00 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) euro.

2. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 5000,00 (pesë mijë) euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 65.000,00 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) euro.

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

1. *Të drejten në aplikim e kanë kooperativat bujqësore që janë të regjistruara në regjistrin e Ministrisë kompetente të Bujqësisë dhe Pylltarisë, të kanë të paktën 5 anëtarë, selinë ta kanë në territorin e Komunës së Graçanicë.*

2. *OJQ-ja që dorëzon aplikacionin duhet të jetë e regjistruar së paku tre vjet para datës së publikimit të Thirrjes Publike, se i ka arsyetuar mjetet e pranuar më parë nga Komuna e Graçanicës dhe se i ka shlyer obligimet tatimore.*

3. *OJQ-ja mund të paraqesë vetëm një aplikacion, i cili do të përfshijë të gjitha aktivitetet e përcaktuara në Thirrjen Publike.*

2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit

1. Për zbatimin e projektit nuk është e detyrueshme dhe as nuk paraqitet si përparësi bashkimi me organizata të tjera.

2. Në rast të bashkimit, organizata – partner duhet t'i plotësojë kushtet e Thirrjes publike të cilat vlejnë edhe për aplikuesin, si dhe dorëzimi i dokumentacionit të mëposhtëm të nënshkruar:

1. Deklarata mbi partneritetin (forma është përcaktuar me Thirrjen publike);

2. Marrëveshja që rregullon në detaje të drejtat dhe detyrimet reciproke të organizatës-aplikues dhe organizatës-partner.

2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

1. Koha e zbatimit të projektit është periudha janar -dhjetor të vitit 2025.

2. Vendi i zbatimit të projektit është në territorin e Komunës së Graçanicës.

3. Llojet kryesore të aktiviteteve që do të financohen përmes thirrjes janë:

•Zhvillimi i bujqësisë dhe rritja e aktiviteteve bujqësore

4. Aktivitetet që nuk janë të pranueshme për financim janë:

1. Aktivitetet që nuk janë të lidhura me fushën e bujqësisë

2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm shpenzimet reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale e këtyre shpenzimeve.

2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Zhvillimi i bujqësisë dhe rritja e aktiviteteve bujqësore

2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

1. Hartimi i materialit promovues

2.4.3 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

1. Pagesën e shpërblimit shtesë për palët e treta të angazhuara në lidhje me çmimin e kontraktuar
2. Pagesën e shpërblimit të veçantë për personat e angazhuar në projekt nga OJQ-ja
3. Blerjen e mobileve, automjeteve dhe të ngjashme
4. Shpenzimet që nuk janë paraparë me Marrëveshjen me Komunën e Graçanicës
5. Donacionet
6. Shpenzimet e tjera që nuk kanë lidhje me projektin e propozuar

3. SI TË APLIKONI?

Aplikacioni i OJQ-së konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha formularët e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si më poshtë:

1. *Formulari i propozim të projektit*
2. *Formulari i propozimit të buxhetit*
3. *Fotokopja e certifikatës për regjistrim të OJQ-së*
4. *Fotokopja e certifikatës për numrin fiskal*
5. *Formulari i deklaramit për mungesën e financimit të dyfishtë*
6. *Formulari i deklaramit për financimin e projekteve nga burimet publike*
7. *Formulari i deklaramit për aktivitetet e përshkruara të projektit*
8. *Forma e deklaratës së partneritetit (nëse zbatohet bashkimi)*
9. *Fotokopja e vërtetimit të detyrimeve të paguara tatimore ndaj ATK-së*
10. *Fotokopja e vërtetimit për shpenzimin e mjeteve në përputhje me destinimin e tyre (nëse aplikuesi ka qenë përfitues i subvencioneve nga ana e Komunës së Graçanicës në vitin e kaluar)*

3.1 Aplikacioni i projekt propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ai përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formularin e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Është e nevojshme që formulari të plotësohet me kompjuter. Nëse formulari është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.

Nëse formulari përshkruet përmban të meta si më sipër, aplikacioni do të konsiderohet i pavlefshëm.

3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

Formulari i propozim buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse formulari i buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Është e nevojshme që formulari të plotësohet me kompjuter. Nëse formulari është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?

Formularët e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga prfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikacioni origjinal duhet të dërgohet me postë ose personalisht në Komunën e Graçanicës-Shkrimorën. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin "*Të mos të hapet para takimit të Komisionit vlerësues*".

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Komuna e Graçanicës

Rruga "Car Lazar" p.n. 10500 Graçanicë

„ Të mos të hapet para takimit të Komisionit vlerësues"

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është më së voni deri më 24.12.2024 në ora 16:00. Kërkesa është dorëzuar brenda periudhës së thirrjes nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në Komunë, aplikantit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

1.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: *opstinagracania@gmail.com*, jo më vonë se 10 ditë para skadimit të thirrjes.

Përgjigjet ndaj kërkesave të veçanta do të dërgohet direkt në adresën e pyetjeve të shtruara, dhe përgjigjet më të shpeshta do të publikohen në faqen e mëposhtme të internetit: *kk.rks-gov.net/gracаницe*, dhe jo më vonë se 5 ditë para skadimit të thirrjes

Për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve të mundshëm, një ofrues i mbështetjes financiare publike nuk mund të japë një mendim paraprak për pranueshmërinë e aplikantëve, partnerët, veprimet apo shpenzimet e përmendura në kërkesë.

4.VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1.Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Ofruesi i mbështetjes financiare do të themelojë një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtarë të institucionit dhe ekspertë tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësojnë aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatisë një listë të të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikacioneve të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfutuese të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kalojë shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve/programeve.

4.2 Dokumentacion shtesë dhe kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, një ofrues i burimeve financiare do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, ofruesi mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Dokumentacioni shtesë që mund të kërkohet është:

- *Dëshmia me shkrim për marrjen me bujqësi për të paktën një vjet*
- *Dëshmia me shkrim mbi mënyrën e pagesës së detyrimeve tatimore të papaguara*

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar, aplikacioni do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve shtesë vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike, nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen nëse, pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse dhe pasi të konstatohet nga institucioni se ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve: Të gjithë aplikantët aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve/programeve në kuadër të thirrjes.

4. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes (vendosni datat)

1. Afati i fundit për aplikim 24.12.2024.
2. Afati për kontraktim *90 ditë nga data e mbylljes së thirrjes.*

Financuesi ka të drejtë të përditësojë kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit e mëposhtme: kk.rks-gov.net/gracanice

5. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

FORMULARËT

1. *Formulari i aplikacionit për projekt/programit (format word)*
2. *Formulari i propozim buxhetit (format excel)*
3. *Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishitë (format word)*
4. *Formulari i draft-kontratës (format word)*
5. *Formulari i raportit financiar (formatin excel)*
6. *Formulari i raportit narrativ-përshkrues (format word)*

7. *Formulari i deklarimit të programeve dhe projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (format word)*
8. *Deklaratën për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin (format word)*
9. *Formulari i deklaratës së partneritetit (format word)*
10. *Formulari për vlerësimin e cilësisë së projektit (format word)*
11. *Formulari për raportimin e zbatimit të projektit (format word)*